



**Procesverbal i Dëgjimeve për
Buxhetin
e vitit 2023 dhe Kornizën
Afatmesme Buxhetore (KAB)
2023-2025
në
Salla e Kuvendit**

INFORMATË RRETH NJOFTIMEVE

Njoftimi për organizimin e dëgjimeve buxhetore për buxhetin e vitit 2023 dhe KAB-in për vitet 2023-2025, u publikua me datë: 01.08.2022 në ueb faqen e komunës së Rahovecit, në këtë vegëz: <https://kk.rks-gov.net/rahovec/wp-content/uploads/sites/23/2022/08/KALENDARI-I-DEGJIMEVE-BUXHETORE-2022.pdf> në harmoni me afatet ligjore që i përcakton Udhëzimi Administrativ, si vijon:

Në mbështetje të nenit 68, paragrafi 68.1 i Ligjit Nr.03L-40 për Vetëqeverisje Lokale të Republikës së Kosovës (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenit 17 dhe nenit 18 paragrafi 1, pika 1.7, të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005, të datës: 29.03.2017, nenit 6 pika 1.3, i Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimet Publike në Komuna, Rregullores Komunale për Transparencë me Nr. Prot. 2697, njoftojmë se nga data: 15.08.2022 deri me datë: 18.08.2022 nën organizimin e Drejtorisë për Financa dhe Buxhet dhe anëtarëve të Grupit punues për hartimin e Projekt-Buxhetit të Komunës së Rahovecit, do të organizohen katër (4) dëgjime publike buxhetore me Bizneset dhe grupet e interesit, për planifikimin e buxhetit për vitin 2023 dhe KAB-in për vitet 2023-2025.

Me qëllim të rritjes së nivelit të transparencës e llogaridhënies dhe për t'i mbajtur sa më të informuar banorët e komunës së Rahovecit, rreth orarit dhe vendit të mbajtjes së dëgjimeve buxhetore, janë bërë me kohë planifikimet dhe është publikuar me kohë kalendar i dëgjimeve buxhetore për katër (4) dëgjimet buxhetore në komunën e Rahovecit në këtë vegëz: <https://kk.rks-gov.net/rahovec/wp-content/uploads/sites/23/2022/08/KALENDARI-I-DEGJIMEVE-BUXHETORE-2022.pdf> më datë: 01.08.2022.

Po ashtu, bazuar në afatet ligjore janë njoftuar OJQ-të, Bizneset dhe Grupet e Interesit, Buxheti Xhinor ku janë janë të informuar edhe gjinia femerore si dhe Bashkësitë Lokale dhe lagjet urbane përfaqësuesit të shkollave dhe rininë, rreth mbajtjes së dëgjimeve me anë të publikimit të secilit njoftim veç e veç, për secilin vendbanim, në ueb faqe të komunës, shtatë ditë para mbajtjes së dëgjimit në atë vendbanim.

Njoftimi për mbajtjen e dëgjimit buxhetor me Bizneset dhe grupet e interesit u publikua më datë: në këtë vegëz:

<https://kk.rks-gov.net/rahovec/wp-content/uploads/sites/23/2022/08/NJOFTIM-DEGJIM-PUBLIK-ME-BIZNESE.pdf>

Njoftimet përveç që janë publikuar në uebfaqe të komunës, në Platformën për Konsultime Publike, në rrjetin social Facebook, njoftimet u janë dërguar edhe kryetarëve të këshillave të fshatrave dhe lagjeve urbane përmes rrjeteve sociale Viber dhe WhatsApp.

DËGJIMI PUBLIK ME Bizneset dhe grupet e interesit

Dëgjimi buxhetor me përfaqësues të Bizneset dhe grupet e interesit që veprojnë në komunën e Rahovecit u mbajtë më: 16.08.2022 në Sallen e Kuvendit Komunal Rahovec, me fillim në ora 11:00.

Zyrtarët pjesëmarrës në këtë dëgjim nga Grupi punes dhe zyrtar komunal ishin: 10

- Femra ishin: 4
- Meshkuj ishin: 6

Qytetarë pjesëmarrës gjithsej të pranishëm ishin: 10

- Femra ishin: 3
- Meshkuj ishin: 7

Dëshmi janë listat nënshkruese të pjesëmarrësve në këtë dëgjim.

Dëgjinin e shpalli të hapur Drejtori i Drejtorisë për Financa dhe Buxhet, z. Afrim Limani.

Afrim Limani: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, të nderuar përfaqësues të Bizneseve dhe grupet e interesit, ju të pranishëm. Faleminderit që sot jeni këtu.

Jemi sot këtu në dëgjetimet buxhetore, për të marrë kërkesat tuaja si Bizneset dhe grupet e interesit, prioritetet që ju keni dhe më pas t'i harmonizojmë në planifikimin që bëhet për vitin 2023.

Buxheti për vitin 2023 do të jetë 17,548,240.00 Euro, Paga dhe medijtje në vlerë prej 8,453,088.00 Euro, Mallra dhe Shërbime në vlerë prej 2,133,829.00 Euro, Shërbime Komunal në vlerë prej 370,000.00 Euro, Subvencione dhe Transfere në vlera prej 820,000.00 Euro si dhe Investimet Kapitale kapin vlerën prej 5,711,323.00 Euro, Mall. Ju lus që kërkesat edhe pasi t'i paraqisni këtu, me shkrim dhe të protokoluara si sjellni dhe në Komunë, që më pas të cëdohen nëpër drejtoritë përkatëse. Nëse ka dikush nga kolegët e KPF-së mund të bashkangjiteni, nëse jo urdhëroni ju përfaqësues të Bizneseve dhe grupet e interesit.

Besmire Bytyçi, qytetare: Të nderuar përshëndetje, i nderuar kryesues dhe ju të pranishëm! Faleminderit që sot jeni këtu me ne.

Kërkesat janë:

- Sheshi qendror i qytetit a është përfshirë ky projekt në buxhetin për vitin 2023

Afrim Limani: Faleminderit juve përfaqësues të Bizneseve dhe grupet e interesit që jeni prezent dhe keni paraqitur kërkesat tuaja.

Mirë u takofshim!

Dëgjimi publik përfundoi në orën: 11:40

Rahovec, 14.9.2022

